



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština -Municipality of Prishtina

## E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

të mbledhjes së tretë të Komitetit konsultativ për personat me aftësi të kufizuara,  
mbajtur më 08.09.2020, e cila filloi në orën 13:30.

Në mbledhje morën pjesë: Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese, anëtarët e Komitetit: Mehreme Llumnica, Ramadan Salihu, Jeton Canhasi, Armend Ademi, Gyltene Retkoceri dhe Ermira Shabani.

Të pranishme ishin edhe Premtime Preniqi, koordinatore e Njësisë për të drejtat e njeriut, Saranda Tara, Ridvan Islami - përfaqësues nga Drejtoria e Arsimit dhe Besa Preniqi - interprete.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese.

Kryesuesja konstatoi se u miratua ky

### REND DITE:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së dytë të Komitetit konsultativ të personave me aftësi të kufizuara;
2. Diskutim lidhur me këto çështje:
  - Kartelat shëndetësore,
  - Trajnimi i stafit shëndetësor,
  - Punësimi i asistenteve për fëmijët me nevoja të veçanta,
  - Liria e lëvizjes dhe
  - Lirimi i PAK-së nga shërbimet komunale etj.
3. Të ndryshme.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së dytë të Komitetit konsultativ të personave me aftësi të kufizuara.

Kryesuesja konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së

**dytë të Komitetit konsultativ të personave me aftësi të kufizuara.**

**Pika e dytë**

**Diskutim lidhur me këto çështje :**

- Kartelat shëndetësore,
- Trajnim i stafit shëndetësor,
- Punësimi i asistenteve për fëmijët me nevoja të veçanta,
- Liria e lëvizjes dhe
- Lirimi i PAK-së nga shërbimet komunale etj.

**Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese, i përshëndeti të pranishmit dhe bëri të ditur se për këtë takim janë ftuar Kryetari i Komunës, nënkyetarët, drejtoresha e Shërbimeve Publike, drejtoresha e Financave, drejtori i Shëndetësisë, ku vetëm një e ka konfirmuar mos ardhjen në takim për shkak se gjendet në pushim vjetor.**

Po besoj se i keni pare në e-mailet e juaja që Komiteti konsultativ për PAK e ka dërguar Planin e veprimit, i cili ka kaluar nga asamblistët, edhe disa ligje dhe nene që i përkasin drejtorive të shërbimeve të tjera.

Të pranishëm e kemi vetëm përfaqësuesin nga Drejtoria e Arsimit, e ndër çështjet që dëshirojmë me diskutuar është çështja e punësimit të asistenteve për fëmijët me nevoja të veçanta. Ne si Komitet e dimë se është viti i tretë që Ministria e Arsimit ndanë buxhet për punësimin e 12 asistentëve për PAK, e në plan e ka për 5 vjetët e ardhshme, mirëpo është viti i tretë që Drejtoria e Arsimit nuk e ka shpallur këtë konkurs, që Komiteti e vlerëson shumë të nevojshëm.

**Ridvan Islami** tha se deri tani ka qenë udhëheqës i Qendrës për këshillim për karrierë në kuadër të Komunës së Prishtinës, e tani si Qendër jemi bashkuar në kuadër të DKA -së dhe jemi pjesë e saj. Në bazë të e-mailit që e pash dhe pikës për diskutim për punësimin e asistenteve për fëmijët me nevoja të veçanta, e di që është ndarë një buxhet prej Ministrisë për punësimin e 100 asistentëve për PAK. Informatën e mora, se si arsyen pse nuk ka mundur me u realizuar deri tani, sepse kur është ndarë buxheti, nuk kanë ndarë kod buxhetor, dhe këto mjete nuk mund të alokohen dhe për këtë arsyen nuk është bërë hapja e konkursit. Me sa e kam kuptuar unë dhe aq sa bisedova, kjo nuk është çështje e Komunës, d.m.th duhet ndoshta me vazhduar prapë Ministria me i bërë presion pozitiv Ministrisë së Financave, që me u caktuar kodi për realizim dhe sa më parë me hapur konkurs për ta realizuar këtë projekt.

**Fatime Demolli - Mustafa** tha se sipas jush, zotëri Ridvan, çështja mbetet tek Ministria e Financave.

**Ridvan Islami** theksoi se ajo duhet të bëhet në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, dhe me përfunduar komplet si proces, sepse shkak është një kod buxhetor.

**Fatime Demolli - Mustafa**, pyeti se çka është duke ndërmarr Komuna për zhbllokimin e këtij kodi, duke pasur parasysh se është viti i tret që janë ndarë mjetet dhe nuk bëhet punësimi i asistentëve, e kjo ndodh vetëm në Komunën e Prishtinës, në vend se ne të jemi shembull për komunat tjera, ne e bllokojmë komplet procesin. Në shumicën e komunave tash kemi konkurse për punësimin e asistenteve, ndërsa Komuna e Prishtinës është viti i tretë që, me dashje apo pa dashje, e neglizhon këtë pjesë që është mjaft e rëndësishme, ndërsa komunat tjera, siç është Komuna e Podujevës, e Ferizajt, e Suharekës, e Dragashit etj. kanë bërë punësimin e asistentëve. **Ridvan Islami**, premtoi se do të interesohet se çfarë metode kanë përdorur këto komunat tjera dhe të shohim si e kanë bërë zgjidhjen.

Në bazë të informatave që mi thanë për shkak të kodit buxhetor nuk është zgjidhur kjo çështje, edhe pse ne jemi si palë në këtë rast që mund ta shtyjmë, por burimet njerëzore janë ato që e shpallin konkursin e jo DKA-ja.

**Fatime Demolli - Mustafa**, u shpreh se nuk mund ta shpallin konkursin Burimet njerëzore pa kërkuar DKA-ja.

**Gyltene Retkoceri** pyeti se a do të ketë ndonjë konkurs në të ardhmen për psikolog nëpër shkolla, duke pasur parasysh sa është e nevojshme, d.m.th. fëmijët me nevoja të veçanta kanë nevojë për psikologë. Tash e katër vjet nuk ka pasur konkurse për psikologë, ku shumica e shkollave në komunën e Prishtinës nuk kanë fare psikolog.

**Ridvan Islami** tha se edhe për psikolog ka informatë edhe për pozita tjera, por problemi po qëndron se Ministria e Pushtetit Lokal po e cakton normën e punësimit, kështu sikurse në çdo institucion që është problem me u punësuar ndonjë person, edhe për psikolog është kjo.

**Ramadan Fazliu**, theksoi se jemi takuar me zotëri Ridvnanin dhe na ka pritur shumë mirë si Komitet, ke qenë nikoqir i yni, por vetëm po arsyetohesh se këto informata i ke, por ne si Komitet thirremi në Planin e veprimit. Kur është hartuar Plani i veprimit, kanë qenë nga Burimet Njerëzore, DKA-ja, Drejtoria e Financave dhe të gjitha këto strukturat vendim marrëse të Komunës, i kanë dërguar përfaqësuesit e vetë në hartimin e Planit të veprimit. Këtu japim vërejtjen se Planit të veprimit, më 31 dhjetor 2020 i skadon afati, d.m.th. që edhe kryesuesja e ceku çështjen e punësimit të këtyre njerëzve e që janë bërë në komunat tjera. Tash, kush e shpall një konkurs ose kush merret me procedurat, është pak e rëndësishme për Komitetin. E rëndësishme për ne është se në puna në këtë drejtim është e barabart me zero. Kështu që ne nuk mundemi me marrë asgjë, vetëm përgjigje, dhe me kërkuar prapë nga DKA -ja që goftë me kontrata mbi vepër, goftë në forma tjera, t'i shfrytëzojë të gjitha mundësitë se është edhe në dobinë e saj, që PAK të jenë të integruar në procesin mësimor e mos të mbisin anash.

**Mehreme Llumnica** tha se ne e kemi parë përkushtimin e z. Ridvanit për çështjen e aftësive të kufizuara gjatë vizitës që kemi pasur, tanë qenka i inkorporuar edhe në DKA, por duhet edhe një bashkëpunimi i ngushtë edhe me përfaqësues që janë thuajse si të thirrur për fëmijët me nevoja të veçanta, e krahas këtij problemi që është shumë madhor dhe kjo që e kemi zgjedhur prej problemeve të shumta që i kemi identifikuar dhe që janë në Planin e

veprimit të parashtruara shumë kërkesa, ku krah Planit është bërë edhe përmes "Save the Children", "Hendikosi" e DKA, është bërë një përparim bukur i madhe me gjithë përfshirjen e fëmijëve prej edukimit parashkollar e më tutje. Por te identifikimi i problemeve që kemi bërë, është edhe problemi i ekipeve vlerësuese, sa janë duke funksionuar tash, kur ka qenë edhe afati i regjistrimit në fund të qershorit.

Ne e kemi një dilemë të madhe, se ekipi vlerësues, që është i përbërë prej disa ekspertëve të fushave të caktuara në Komunën e Prishtinës, nuk është shumë funksional, duke parë numrin e madh të nxënësve dhe banorëve, është i pamjaftueshmë vetëm një komision me atë përbërje të vogël pér t'i vlerësuar fëmijët pér regjistrim në edukimin parafillor dhe fillor pér me i përfshirë në shkollim. Nuk e di sa jeni në rrjedha, por a ka funksionuar këtë vit kur ka qenë koha e regjistrimit dhe sa do të rifunksionojë ai.

**Fatime Demolli - Mustafa** tha në kushte që jemi tash pér tash, në kushte pandemie, ekipi vlerësues komunal nuk ka funksionuar, nuk ka bërë vlerësim të fëmijëve.

**Mehreme Llumnica** pyeti se si do të përfshihen ata fëmijë, sepse ka qenë koha e regjistrimit, ku kanë mbetur tani, a merret dikush me ata fëmijë.

**Ridvan Islami** tha se komisioni normalisht se është funksional dhe besoj se me fillimin e mësimit në shkolla do të fillojnë edhe këta.

**Mehreme Llumnica** parashtroi pyetjen lidhur me transferin e z. Ridvanit në DKA dhe pyeti se a keni me e mbikëqyrë Qendrën e karrierës.

**Ridvan Islami** tha se Qendra është e Komunës së Prishtinës. Ju kur keni qenë në vizitë, e keni parë se Qendra i plotëson të gjitha kushtet infrastrukturore. Qendra tanë është pjesë e drejtorisë së DKA -se dhe është funksionale. Unë prapë jam menaxher i saj, e më parë Qendra ka qenë pjesë e Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik.

**Mehreme Llumnica** pyeti a ka pasur deri tanë ndonjë nxënës me aftesi të kufizuara që ka marrë pjesë në trajnime, ose që ka qenë i interesuar, dhe nëse po, me çfarë aftësie të kufizuara kanë qenë ata nxënës.

**Ridvan Islami** dha sqarime pér këtë, duke thënë se kemi pasur numër simbolik, por nuk kemi bërë ndonjë trajtim special, si të tjerët është trajnuar dhe është identifikuar me emër e mbiemër, klasat e dympëdhjeta zgjedhin, mbajnë trajnim si me ardhur te tregu i punës, si me e përgatitur një CV, një letër motivuese, si me u përgjigjur në intervistë etj. d.m.th. nuk ka përashtime. Siç e keni parë, infrastruktura është në rregull, nuk ka ndonjë pengesë që i pengon në pjesëmarrje në Qendër.

**Mehreme Llumnica** pyeti se a e kanë obligim me ardhur pasi ta kryejnë klasën e dympëdhjetë, apo i përzgjedh shkolla dhe ua transmeton juve informatën.

**Ridvan Islami** tha se me përashtim të këtij viti, ne çdo herë, në çdo shtator i kemi listat e të gjithë nxënësve të klasave të dympëdhjeta dhe i ftojmë e bëjmë një orar, ku caktohen shkollat me radhë dhe mbahet trajnimi që zgjat dy ditë.

**Ramadan Fazliu** tha se ne kemi qenë bashkë te zotëri Ridvani, ku na i ka ofruar mundësitë më të mira, më të mundshme, i pamë vetë resurset që i kishin dhe na është thënë neve si Komunitet le të na ofrojnë neve, se çka mundemi ne me bërë pér juve. Ne si Komitet, i kemi

informuar OJQ-të për këtë, Qendra kishte kushtet e mira, resurset humane, infrastruktura shumë e mirë, mundësitet ishin të mira, andaj së bashku ta hartojmë një strategji se si t'i kyçim nxënësit PAK, që të arrijnë diçka aty. Por këtu kemi ngecje të OJQ-ve, d.m.th. nuk kemi informacione kthyese se si e kanë parë ata mundësinë që në Qendrën për trajnimin të arrijnë diçka.

**Ridvan Islami** u shpreh se ne qëndrojmë prapa fjalëve që i kemi thënë, që e kemi misionin me i trajtuar këto shkolla. Kur themi këto shkolla, çdoherë duke përfshirë edhe këta nxënës. Sa u përket personave të shurdhër, ne nuk kemi interpretues, nuk kemi mundësi dhe nuk kemi burime njerëzore për të gjitha këto kategoritë, por ne jemi të hapur për bashkëpunim.

**Armend Ademi** tha se shoqata jonë është e hapur për çdo bashkëpunim që do të kishim pasur me Qendrën e që do t'i përfshinte personat e shurdhët, jemi të gatshëm për bashkëpunim. **Premtime Preniqi** dha si informatë për përfaqësuesin e DKA-së, duke thënë se sa herë të kenë nevojë për interpretues të gjuhës së shenjave, t'i drejtohet Zyrës për qeverisje të mirë dhe mundësi të barabarta dhe do t'iu sigurojë interpretuesin.

**Fatime Demolli - Mustafa** pyeti se a është fjala për trajnim dyditor, a është trajnim për të rritur dhe sa mundet me qenë grupi minimal i ndjekjes së këtij trajnimi.

**Ridvan Islami** theksoi se në grup secila shoqatë, si ajo e Autizmit, e të Shurdhërve, Sindrom Daun etj., të formon dy -tri grupe dhe i kompletojmë të gjitha që na duhen dhe organizojmë trajnim me shkathtësi të buta, në këtë rast me persona të rritur prej 18 e tutje. Tani duhet me iu përmbajtur rregullave antikovid, përndrysht 15-20 persona munden me qenë në hapësirë, në këtë rast është mirë 10 persona.

**Fatime Demolli - Mustafa** në kushte pandemie mendoj se do të mund të ishin 10-12 persona.

**Mehreme Llumnica** tha se do të ishte mirë që ky trajnim me rezultuar edhe komplet, Qendra e karrierës është e interesuar edhe me biznese, por për të ardhur deri te tregu i punës së PAK, duhet shumë me hulumtuar e me marrë edhe atë për sipër, siç e keni për të gjithë nxënësit e tjerë, me bërë një angazhim maksimal bashkë edhe me OJQ-të.

**Ridvan Islami** dha sqarime, duke cekur se shumë me rëndësi është ajo se çka i mësojmë, se ka shumë të them profesional, në kuqtimin e aftësive të forta që i kanë marrë në shkolla, por nuk din me aplikuar me një vend pune shkathtësitet e buta, e ti nëse nuk di ta dërgosh një e-mail ose një letër motivuese, qysh kërkohet tani në tregun e punës, t'i nuk ki me arritur me qenë pjesë e intervistës etj.

**Ermira Shabani** bëri të ditur se para disa ditëve ia kanë dërguar një kërkesë Drejtorisë së Arsimit, Drejtorisë së Mirëqenies Sociale dhe Drejtorisë së Shëndetësisë. na po mendojmë që me hapjen e shkollës, po mendojmë tani me hapur edhe Qendrën që ofron shërbime për zhvillime terapeutike për fëmijët me Sindrom Dowen. Kemi paraqitur kërkesën që kjo Qendër me u trajtuar ashtu si trajtohen kopshtet apo shkollat. Për masat antiCovid, d.m.th. për arsim, si dhe protokollin që e bën Komuna e Prishtinës për hapjen e kopshteve, ndoshta kishte qenë mirë me marrë parasysh me shqyrtauë këtë mundësi në këtë kohë, p.sh për mjetet dezinfektuese, termometër, dezinfektimin e hapësirave me ua ofruar edhe këtyre qendrave që ofrojnë shërbime terapeutike për këta njerëz, për këta fëmijë.

**Ridvan Islami** pyeti se sa qendra planifikohen të hapen.

**Ermira Shabani** u përgjigj se " Sindrom Dowen" e ka vetëm një Qendër në Prishtinë, aty marrin shërbime terapeutike edhe Shoqata e Autizmit, janë ato faktikisht tri, "Hendikosi ", ka edhe shumë të tjera.

**Ridvan Islami**, tha se është mirë me na shkruar e-mail dhe me na i drejtuar sa kërkesa janë. **Ermira Shabani** tha se iu kam dërguar e-maili drejtoreshës së Arsimit, Shpresa Shala, drejtoritë të Mirëqenies Sociale, Dren Kukaj, dhe drejtorit të Shëndetësisë, Bujar Gashit, por nuk kam marrë përgjigje.

**Fatime Demolli - Mustafa**, tha unë kisha kërkuar testimin për stafin e OJQ-ve para se me filluar punën direkt me fëmijët, se në protokoll është testi i stafit.

**Ridvan Islami**, tha besoj që pa problem ua cakton dr. Bujari këtë çështjen e testimit.

**Armend Ademi**, sa i përket trajnimit, tha se unë kam mbajtur trajnim në OSBE më herët për këto temat, për letrat motivuese, CV-në etj., kështu që vetëm nëse mbahet trajnimi në uikend mundem me marrë pjesë pa problem, ndërsa ditët tjera e kom shumë të vështirë.

**Premtime Preniqi** tha se nuk është e thënë Armend me marrë pjesë ju drejtpërdrejt, por anëtarët e Shoqatës.

**Ramadan Fazliu** pyeti se çka ka ndodhur lidhur me çështjen e regjistrimit të fëmijës Shkëmb Vrajolli në institucionin parashkollar, që nuk është pranuar më herët.

**Fatime Demolli - Mustafa** u përgjigj se ajo çështje nuk është zgjidhur, nuk është pranuar.

**Ramadan Fazliu** tha se jemi të pafuqishëm ne si Komitet në këtë drejtim, por ne çdo mbledhje kemi me ngritur këtë rast, sepse është rast i diskriminues.

**Ridvan Islami**, theksoi se çerdhet me bazë në komunitet funksionojnë pak më ndryshe, për shkak se prindërit janë vendimmarrës, ligjërisht kompetencat i kanë prindërit.

**Premtime Preniqi** bëri të ditur se ai fëmijë është i pranuar në çerdhen shtetërore dhe është larg shtëpisë, ndërsa çerdhen me bazë në komunitet e ka afër shtëpisë dhe pse mos me pranuar kur i plotëson të gjitha kushtet, plus me bazë në komunitet. Komuna i financon prindërit që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara dhe fëmija ka me qëndruar gjysmë orari, por e ka edhe asistentin.

**Ridvan Islami** pyeti se çfarë arsyetimi kanë bërë lidhur me këtë çështje.

**Ermira Shabani** theksoi se nuk ka ndonjë arsyetim konkret. Kur kemi qenë si ekip në takim, unë pash se kopshti faktikisht nuk është problem po themi për fëmijën me Sindrom, i përshtaten pak a shumë kushtet. Këtë çështjen e fëmijës e kemi ngritur përmes Komitetit dhe shoqatës Sindrom Dawn. Po ashtu, edhe tani kur është bërë regjistrimi, kemi pasur një rast të njëjtë, ku nuk është pranuar fëmija dhe e kemi ngritur, unë vetë kam dërguar e-mail dhe iu kam thënë se po duket si fenomen i përhapur është bërë që këto kopshte mos mi pranuar fëmijët me aftësi të kufizuara, posaçërisht fëmijët me Sindrom Dowen.

**Gyltene Retkoceri** tha se prindërit nuk po dëshirojnë këta fëmijë me i pranuar në çerdhe me bazë në komunitet.

**Ridvan Islami** tha në çerdhe kur të aplikohet, zakonisht fëmija nuk dihet kush është me emër, vetëm me kritere dihet.

**Fatime Demolli - Mustafa** e falënderoi zotëri Ridvanin për përgjigjet e dhëna.

Në bazë të diskutimeve, Komitetit konsultativ për personat me aftësi të kufizuara nxori këto

#### REKOMANDIME:

Faqe 6 nga 8

1. Drejtoria komunale e Prishtinës të shqyrtojë se si me funksionalizuar, ose si me bashkëpunuar për rekrutimin e asistentëve, për këtë kodin, ose me bashkëpunuar me komunat tjera se si e kanë marrë atë kod, siç janë Komuna e Podujevës, e Dragashit, e Ferizajt, e Drenasi etj., d.m.th. si çështje e parë punësimi i asistentëve.
2. Zotëri Ridvani me biseduar me Liridona Preniqin, që Ekipin Vlerësues komunal përfëmijët me nevoja të veçanta, ta funksionalizojë sa më shpejt që është e mundur, duke pas parasysh pandeminë, dhe t'i përshtatet kushteve pandemike, në të kundërtën, kemi mbetur keq sidomos arsimi.
3. Trajnimi i personave të cilët ndodhen në OJQ për Qendrën e karrierës, që do ta shqyrtojmë mundësinë si Komitet të trajnohemë edhe ne në këtë Qendër, në mënyrë që t'u përcjellim pastaj shoqatave të tjera numrin se a dëshirojnë.

**Mehreme Llumnica** tha se në kohën e pandemisë Ministria e Shëndetësisë i paska kryer psikologë dhe ata psikologë i kanë bërë mobil, 2-3 shkolla një psikolog.

Po ashtu, tha QMF tani specializantë që ka kërkuar Ministria e Arsimit asnjë mjek familjar nuk e ka dërguar në specializim, të gjitha komunat po, e kjo jo. Unë e di sa mjeku i MF -së del në pension, e sot nuk është në gjendje me quar as në specializim drejtoria e Shëndetësisë një mjek familjar, ose me vetëfinancim, ose në mënyrë tjetër, nuk ka hapur konkurs fare.

**Gyltene Retkoceri** tha se krejt komunat tjera kanë nëpër QMF psikologë, e Komuna e Prishtinës si kryeqytet, ka qendra që nuk kanë psikolog, ndoshta pacienti nuk ka nevojë përmjekun familjar por përmjekun, por ai shkon e ngarkon me terapi.

**Armend Ademi** u shpreh se punën primare e kemi punën e fëmijëve, që fëmija të arrijë të edukohet pak a shumë, e pastaj punët tjera. Ne pe shohim se komunat e tjera në disa çështje po avancohen më shumë, kështu që ne duhet me bashkëpunuar me Ministrinë dhe me shikuar se ku është problemi.

Sa i përket punës së buxhetit, nuk po kuptoj që janë nda qe tri vite dhe nuk ka mbërri me u gjetur zgjidhje brenda këtyre viteve, me u specifiku ku është problemi dhe me vazhduar tutje e mos me mbetur ai projekt pa u realizuar.

**Ridvan Islami** u shpreh i pajtimit me shqetësimet e paraqitura dhe premtoi se do të shikojnë mundësitë se çka munden me bërë.

### Të ndryshme

**Armend Ademi** tha se te rampa te Stacioni i Autobusëve, e ka prezantuar librezën e anëtarësimit dhe nuk ia kanë njobur. Është mirë me kontaktuar me kushdo që është përgjegjës atje, me qenë të liruar prej pagesës, me i njoftuar, se siç e vërejta ata punëtorë nuk janë të informuar përmjekun familjarët e anëtarësimit, që PAK dhe Shoqatat janë të liruara nga pagesa në rampën te Stacioni i autobusëve. **Fatime Demolli - Mustafa**, pyeti se kush kujdeset përmjekun familjarët e anëtarësimit.

rampë, punëtorët e Komunës apo të Sektorit të Trafikut Urban, apo ndonjë kompani private, sepse nëse është kompani privat Komiteti nuk mundet me ndihmuar shumë.

**Armend Ademi** dha sqarime, duke cekur se sipas të dhënave që i ka, është në mbikëqyrje të Komunës së Prishtinës.

**Fatime Demolli - Mustafa** i tha Armendit ta përgatit e-mailin dhe t'ua dërgoj.

**Mehreme Llumnica** tha se unë po mendoj që të dërgohet vetëm në emër të Komitetit të shurdhërve, pasi që këta kanë problem.

**Fatime Demolli - Mustafa** i propozoi Armendi të shkruaj një e-mail çka më konkretisht, e pastaj t'ia dërgojë anëtarëve të Komitetit. Nëse anëtarët e Komitetit kanë me shtuar diçka, mirë, nëse jo, atëherë zotëri Ramadani në mënyrë juridike e përgatit një shkresë dhe ia dërgojmë në mënyre zyrtare personave kompetent.

**Premtime Preniqi** tha se është e njëjtë çështje sikurse "Trafiku Urban", që e ka qitur në autobusë për me u lejuar nga pagesa PAK.

**Fatime Demolli - Mustafa** propozoi për mbledhjen e radhës, për takime tjera me drejtor, ta ftojnë nënkyjetarët dhe ta marrin më seriozisht çështjen e takimeve.

**Ramadan Fazliu** tha se çështjet që i ceku Armendi lidhur me lirimin nga tarifa, do t'ju shkruaj atyre, mirëpo në muajin e ardhshëm është Dita për personat me shkopin e bardhë, e shënojmë, Komiteti në rrallë të pari të merret me këtë punë, e pastaj edhe për çështjet tjera.

**Premtime Preniqi** sugjeroi që mos ta lënë në neglizhencë çështjen e listave për personat që me ndjekur trajnimin, për stafin të cilin doni me e dërguar për trajnim.

**Fatime Demolli - Mustafa** tha unë po mendoj që së pari me u trajnuar Komiteti.

**Premtime Preniqi**, unë kisha thënë nxënësit, gjeneratat e reja, d.m.th. prej moshës 18-19 vjeç.

**Ermira Shabani** propozoi, në kontakt me zyrtarin, Ridvanin, me na dërguar një e-mail neve anëtarëve të Komitetit, e ne si Komitet secili e shpërndajmë nëpër Organizatat tona ku jemi dhe Organizata i njoftojnë anëtarët e vetë dhe krijohet një lloj shërbimi që po i ofron Komuna.

**Premtime Preniqi** tha unë nuk kisha thënë ashtu, se ajo shkon proces, kjo është sikurse herën tjetër që i keni bërë listat për pastrim, a për çfarëdo që ka qenë.

**Ramadan Fazliu** tha si Komitet me iu shkruar të gjitha OJQ-ve, këtë mundësi e kemi, nëse jeni të interesuar i qitni listat dhe propozimet për çka doni me i aftësuar anëtarët e juaj, po ne vetëm pa OJQ nuk mundemi me bërë asgjë.

*Mbledhja përfundoi në orën 14:45.*

Procesmbajtësja:  
Shyhrete Islami

Kryesuesja e Komitetit  
Fatime Demolli - Mustafa

Faqe 8 nga 8

